URDHËRESË
Nr.5, datë 25.5.1990

PËR QARKULLIMIN MONETAR DHE KONTROLIN BANKAR NË FONDIN E PAGAVE

Në mbështetje të ligjit nr.7377, datë 8.5.1990 "Për Bankën e Shtetit Shqiptar" dhe nr.7378, datë 8.5.1990 "Për bankën Bujqësore", Këshilli i Ministrave nxjerr këtë:

URDHËRESË:

KREU I
PËR QARKULLIMIN MONETAR

Neni 1

Qarkullimi monetar në ekonominë tonë socialiste është i planifikuar dhe i centralizuar. Ai rregullohet nëpërmjet planit të arkës së Bankës së shtetit shqiptar, i cili pasqyron xhiron me para në dorëtë ekonomisë, nevojat për mjete monetare dhe ndryshimin e monedhës në qarkullim. Plani i arkës hartohet në mbështetje të treguesve të planit të shtetit, të buxhetit të shtetit, të bilancit të të ardhurave e të shpenzimeve monetare të popullsisë dhe monedhës në qarkulllim.

Neni 2

Plani vjetor i arkës së Bankës së shtetit Shqiptar, sipas zërave kryesorë, miratohet nga Këshilli i Ministrave, kurse plani tremujor dhe përmirësimet që bëhen në planin vjetor të arkës, miratohen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, Ministritë e institucionet e tjera qendrore dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar treguesit përkatës të planit vjetor të arkës, ndarë në tremujorë sipas rretheve, dhe ndryshimet që u bëhen atyre gjatë vitit, brenda afateve të caktuara në metodologjinë e planifikimit të ekonomisë socialiste.

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar u dërgon komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe degëve të Bankës së Shtetit Shqiptar planin vjetor të arkës, ndarë në tremujorë.

Ndërmarrjet, institucionet dhe kooperativat bujqësore u dërgojnë degëve të bankës së Shtetit Shqiptar dhe degëve të Bankës Bujqësore, brenda afateve të caktuara në metodologjinë e planifikimit, planin vjetor të arkës, ndarë në tremujorë, dhe 25 ditë para fillimit të tremujorit ndarjen e tij në muaj.

Neni 3

Të ardhurat nga qarkullimi i mallrave dhe kryerja e shërbimeve me para në dorë për ndërmarrjet, institucionet e kooperativat bujqësore konsiderohen vetëm paratë e derdhura në Bankës e Shtetit Shqiptar.

Treguesit e shpenzimeve të planit të planit të arkës janë kufij maksimalë. Lejohet kryerja e shpenzimeve mbi planin e miratuar, vetëm kur ato shoqërohen me rritje të prodhimit e ndërtimit dhe të ardhurave nga qarkullimi i mallrave e shërbimet.

Neni 4

Dega e Bankës së shteit shqiptar, me kërkesën e ndërmarrjeve, të institucioneve e të kooperativave bujqësore, cakton afatet e dhënies së pagave, të parashikuara në planin e arkës. Çeku i pagave paraqitet në Bankë një ditë më parë. Lejohet kryerja e pagesave drejtpërdrejt, pa kaluar nëpërmjet bankës, nga arka e ndërmarrjes, e institucionit dhe e kooperativës bujqësore deri në 200 lekë në ditë.

Neni 5

Ndërmarrjet, institucionet dhe koopertivat bujqësore mbajnë përgjegjësi dhe kanë për detyrë të arkëtojnë çdo ditë nga njësitë e tyre vartëse të ardhurat nga shitja e mallrave, kryerja e shërbimeve etj, dhe t'i derdhin këto tërësisht në bankë jo mëvonë se ditën e nesërme, me përjashtim të ditëve të diela dhe të festve zyrtare. Dega e Bankës të Shtetit Shqiptar cakton afate të diferencuara për njësitë që ndodhen larg, por jo më shumë se 5 ditë kalendarike.

Neni 6

Derdhja e parave nga njësitë brenda qyteit bëhet çdo ditë në arkat e ndërmarrjeve e të institucioneve. Njësitë e ndërmarrjeve bujqësore dhe të kooperativave bujqësore që tregtojnë npë qytet, paratë i derdhin çdo ditë drejtpërdrejt në Bankën e shteit Shqiptar, në njësitë e caktuara prej saj.

Nga njësitë brenda fshatit, ku ndodhet arka e shërbimit bankar, derdhja e parave bëhet çdo ditë drejtpërdrejt nga vetë punonjësit e këtyre njësive. Për të gjitha njësitë e tjera në fshat arkëtimi i parave dhe derdhja e tyre në bankë kryhet nga punonjës të veçantë, të ngarkuar nga ndërmarrjet, institcionet dhe kooperativat bujqësore.

Neni 7

Shitësit dhe arkëtarët e rinj të tregtisë e të shërbimeve brenda qytetit të Tiranës derdhin xhiron ditore, duke e depozituar me çanta të veçanta në kasaforta të posaçme, të caktuara përkëtë qëllim nga Banka e Shtetit Shqiptar. Diferencat që vërtetohen në shumat e depozituara kalojnë për llogari të derdhësve, në bazë të procesverbaleve të komisionit numërues të bankës, në të cilin marrin pjesë jo më pak se tre punonjës.

Neni 8

Njësia monetare në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë është leku.

Kartëmonedhat përbëhen nga prerjet 1,2,3,5,10,20,25,50 dhe 100 lekë. Monedhat metalike përbëhen nga prerjet 1 e 2 lekë dhe nga 5.10, 20 e 50 qindarka.

Neni 9

Ndalohet nxjerrja dhe prurja nga jashtë shtetit e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike në lekë që janë në qarkullim, me përjashtim të rasteve të lejuara me dispozita të veçanta. Shtetasit shqiptarë që shkojnë jashtë shtetit, lejohet të marrin me vete deri në 200 lekë, me përjashtim të prerjeve 100 lekëshe, të cilat detyrohen t'i deklarojnë pranë organeve përkatëse në kohën e daljes nga kufiri, nga porti ose aeroporti, dhe këto para t'i sjellin prësëri në kohën e kthimit të tyre në atdhe.

Neni 10

Ndërmarrjet, institucionet e kooperativat bujqësore mbajnë përgjegjësi dhe kanë për detyrë të marrin të gjitha masat enevojshme për sigurimin fizik, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kartëmonedhave e të monedhave metalike të emetuara nga Banka e Shtetit Shqiptar, në arkat e tyre, si dhe gjatë lëvizjes së parave sipas dispozitave të veçanta.

Neni 11

Banka e Shtetit shqiptar ngarkohet të tërheqë nga qarkullimi kartëmonedhat dhe monedhat metalike të dëmtura e të papërshtatshme. Ajo nuk pranon për ndërrim kartëmonedhat dhe monedhat metalike të dëmtuara, kur kanë humbur karakteristikat kryesore origjinale të tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit bën asgjesimin e kartëmonedhave e të monedhave metalike të tërhequra nga qarkullimi me komision të posaçëm të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës së shtetit Shqiptar. Për çdo rast mbahet procesverbal i veçantë.

Neni 12

Degët e Bankës së Shteit Shqiptar, kur u paraqitën kartëmonedha dhe monedha metalike false, ose të dyshimta për falsfikim, detyrohen t'i mbajnë ato, të përpilojnë dokument të veçantë dhe t'ia dërgojnë menjëherë Drejtorisë së Përgjtihshme të Bankës së Shtetit Shqiptar, e cila ua dërgon për analizë e ekspertizë organeve përkatëse dhe, kur është rasti për ndjekje penale, organeve të hetimit.

KREU II
PËR KONTROLIN BANKAR NË FONDIN E PAGAVE

Neni 13

Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore ushtrojnë kontroll dhe kryejnë pagesat e fondit të pagave për ndërmarrjet në raport me plotësimin e vëllimit në vleftë të produktit mall industrial të shitur, prodhimit bujqësor përfundimtar, ndërtimet, shërbimeve dhe qarkullimit të mallrave (kontroll ekonomik), kurse për institucionet buxhetore në përputhje me planin e fondit të pagave të miratuar (kontroll limit).

Nuk konsiderohen tejkalime të fondit të pagave efektet që rrjedhin nga zabtimi i dispozitave të veçanta që lidhen me pagën dhe shpërblimin e punonjësve.

Neni 14

Ndërmarrjet u dërgojnë degëve të Bankës të Shtetit Shqiptar ose degëve të bankës Bujqësore, brenda afatit të caktuar në metodologjinë e planifikimit, planin vjetor, si dhe ndryshimet që bëhen gjtë vitit, të miratuar sipas kompetencave, të ndarë në tremujorë e muaj me zërat.

a) Vlefta e vëllimit të produktit mall industrial të shitur, prodhimit bujqësor përfundimtar, ndërtimit, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve.

b) Fondi i pagave gjithsej.

Institucionet buxhetore dërgojnë vetëm fondin e pagave.

Neni 15

Ndërmarjet, institucionet, repartet ushtarake dhe organizatat shoqërore në mbarim të çdo muaji, një ditë para tërheqjes së pagave, paraqesin në bankë të dhënat për plotësimin e treguesve sipas nenit 14 të kësaj urdhërese mujore e progresive prej fillimit të vitit, sipas formularit të miratuar nga Drejtoria e përgjithshme e Bankës së Shtetit.

KREU III
SANKSIONET

Neni 16

Presoneli drejtues administrativ, inxhiniero-teknik dhe ekonomik i ndërmarrjeve e institucioneve, si dhe kuadri komandues dhe ushtarakë të tjerë që kanë funksione drejtuese në njësi të bashkuara e reparte ushtarake dhe ato të Ministrisë së Punëve të brendshme, për shkeljen e dispozitave të parashikuara në nenet 3,4,5,10 e 13 të kësaj urdhërese, kanë përgjegjësi materiale gjer në masën e një page mujore.

Përgjegjësi materiale deri në një pagë mujore kanë edhe punonjësit e degëve të bankës në rrethe, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, kur lejojnë shkeljet e mësipërme.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Banka e Shteti Shqiptar dhe Banka bujqësore ushtrojnë kontroll mbi ndërmarrjet, institucionet, repartet ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes Populllore e të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe mbi kooperativat bujqësore, për zbatimin e dispozitave të kësaj urdhërese dhe, kur vërejnë shkelje, mbajnë procesverbale për nxjerrjen e përgjegjësisë prej organeve kompetente, në përputhje me dispozitat në fuqi, si dhe ndërhyjnë e vënë detyra për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Neni 18

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar ngarkohet të nxjerrë udhëzim të veçantë për zabtimin e kësaj urdhërese, që është i detyrueshëm për të gjitha ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe organet e tyre vartëse.

Neni 19

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 27.8.1982 “Për qarkullimin monetar dhe nr.7, datë 11.12.1985 “Për kontrollin bankar në fondin e pagave”, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese, shfuqizohen.

Neni 20

Kjo urdhëresë hyn në fuqi më 1.7.1990.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Adil Çarçani